Informacione në përputhje me nenin 13 të Rregullores (BE) 2016/679
Rregullore për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me trajtimin e të dhënave personale (RGPD).

Trajtimi i të dhënave personale për kryerjen e testit për përcaktimin e rrezikut nga aneuploidie të kromozomeve 21, 18, 13 dhe të kromozomeve seksuale me anë të sekuenciamentit të ADN-së së lirë qarkulluese në plazmën materne.

Qëllimet dhe baza juridike e trajtimit të të dhënave personale.
Trajtimi i të dhënave personale do të bëhet me synimin e mbrojtjes së shëndetit, si dhe për aktivitetet administrative që kanë lidhje me këtë qëllim.
Baza juridike e trajtimit paraqitet nga neni 9 paragrafi 2 germa g), nga neni 9 paragrafi 2 germa h) e nga neni 9 paragrafi 3 i RGPD-së (Rregullorja e përgjithshme për mbrojtjen e të dhënave); përveç kësaj, duke iu referuar trajtimeve të nevojshme për arsye interesi publik, me rëndësi për sa i përket nenit të sipërpërmendur n. 9 paragrafi 2 germa g), nga neni 2-sexies koma 2 germat t), u), aa) të D.Lgs. 30 qershor 2003 n. 196 *Kodi në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale* e (deri në dispozitat e reja rajonale) nga skedat 21 e 24 të aneksit B te Rregullorja sipas D.P.G.R. 12 Shkurt 2013 N. 6/R.
Rezultatet e testit do të transmetohen gjithsesi te struktura që e ka dërguar.
Për trajtimin e të dhënave, për qëllimet e lartpërmendura, nuk nevojitet miratimi i të interesuarës.
Trajtimi i të dhënave kryhet në përputhje me përshkrimet që parashikohen nga autorizimi i Autoritetit Garant për mbrojtjen e të dhënave personale 8/2016 ashtu siç është modifikuar nga vendimi i datës 13 dhjetor 2018 për përcaktimin e përshkrimeve të Autorizimeve të përgjithshme që janë në përputhje me RGPD.

Të interesuarës, nëse ajo e dëshiron, i kërkohet:

- të lejojë që, rezultatet e testit (analizave), kur është me rrezik të lartë ose me fraksion fetal (FF) të papërshtatshëm, të dërgohen edhe te Centro di Diagnosi Prenatale (Qendra e Diagnozës Prenatale) që është zgjedhur nga ajo vetë;
- të lejojë që rezultatet e testit të dërgohen edhe te Qendra pranë së cilës është kryer testi i kombinuar;
- të autorizojë personelin e SOD Diagnostica Genetica të AOU Careggi dhe Centro di Diagnosi Prenatale të sipërpërmendur ta kontaktojë me anën e telefonit në lidhje me rezultatin e testit ose të *follow up* (asistencës pas testit).

Për këto qëllime baza ligjore përbëhet pikërisht nga miratimi i palës së interesuar, pra nga neni 9 paragrafi 2 germa a) e RGPD-së.

Tipologjitë e të dhënave të trajtuara.
Për të kryer testin, do të trajtohen tipologjitë e mëposhtme të të dhënave personale ("çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm: konsiderohet i identifikueshëm personi fizik i cili mund të identifikohet, direkt ose indirekt duke iu referuar veçanërisht një identifikuesi si emri, një numri identifikimi, të dhënave që kanë lidhje me vendndodhjen, një identifikuesi on-line apo një ose më shumë elementë karakteristikë të identitetit të tij fizik, fiziologjik, gjenetik, psikik, ekonomik, kulturor ose social":
- të dhënat gjenetike ("të dhënat personale në lidhje me karakteristikat gjenetike të trashëguara ose të fituara të një personi fizik që japin informacione univoke mbi fiziologjinë ose mbi shëndetin e atij personi fizik dhe që rezultojnë në veçanti nga analiza e një kampioni biologjik të personit fizik në fjalë");
- të dhëna që kanë lidhje me shëndetin ("të dhënat personale që kanë të bëjnë me shëndetin fizik ose mendor të një personi fizik, duke përfshirë dhënien e shërbimeve të asistencës shëndetësore, të cilat zbulojnë informacione në lidhje me gjendjen e tij shëndetësore").

Modalitetet e trajtimit.
Kampioni biologjik i prelevuar, i shoqëruar nga një skedë informative, transmetohet nga struktura që ka në ngarkim të interesuarën te SOD Diagnostica Genetica e AOU Careggi, që do të kryejë testin.

Informazione në përputhje me nenin 13 të Rregullores (BE) 2016/679
Rregullore për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me trajtimin e të dhënave personale (RGPD)

Trajtimi i të dhënave personale për kryerjen e testit për përcaktimin e rrezikut nga aneuploidie të kromozomeve 21, 18, 13 dhe të të kromozomeve seksuale me anë të sekuenciamentit të ADN-së së lirë qarkulluese në plazmën materne

Rezultatet e testit (analizave) do të transmetohen, me modalitetin elektronik, në përputhje me përshkrimet e Autorizimit të lartpërmendur n. 8/2016, tek struktura e dërguesit dhe, nëse lejohet nga e interesuara, në Qendrën ku është kryer testi i kombinuar. Në rastin e një rezultati me rrezik të lartë dhe nëse lejohet nga e interesuara, rezultatet e testit mund të transmetohen edhe në Qendrën e diagnozës prenatale përkatëse. Sidoqoftë, të gjitha rezultatet do të jenë në dispozicion për t'u tërhequr nga ana e të interesuarës pranë strukturës së dërguesit (d.m.th. te struktura ku ka bërë prelevimin).
Nëse e asistuara e lejon, mund të kryhen komunikimet telefonike të sipërpërmendura nga Qendra e Diagnozës Prenatale (Centro di Diagnosi Prenatale) të parazgjedhur dhe nga SOD Diagnostica Genetica e AOU Careggi.
Trajtimi i të dhënave personale të së interesuarës do të kryhet si me anën e suportit në letër, ashtu si dhe me përdorimin e mjeteve elektronike, duke marrë masat paraprake dhe të sigurisë që parashikohen nga normativa në fuqi.

Ushtrimi i të drejtave nga ana e të interesuarit.
I interesuari ka të drejtë që:
- të marrë kurdoherë informacione në lidhje me përdorimin e të dhënave që kanë lidhje me të;
- të ketë akses te të dhënat që kanë lidhje me të;
- të kërkojë korrigjimin ose integrimin;
- të kërkojë, në disa raste të mundshme që parashikohen nga normativa, kufizimin e trajtimit;
- të kundërshtojë trajtimin e të dhënave që kanë lidhje me të;

Për të ushtruar të drejtat e lartpërmendura, personi i interesuar mund t'i dërgojë një kërkesë Përgjegjësit për mbrojtjen e të dhënave personale, të dhënat e të cilit paraqiten më poshtë.
I interesuari ka gjithashtu të drejtë që të paraqesë një ankesë te Garanti për mbrojtjen e të dhënave personale.

Titullari, Përgjegjësi dhe personali i autorizuar për trajtimin e të dhënave.
Titullari për trajtimin e të dhënave është Ndërmarrja: _____,
që ka në ngarkim të asistuarën dhe procesin përkatës të kurave.
AOU Careggi, nëse kryen aktivitete laboratorike për llogari të Ndërmarrjeve të tjera sanitare, do të kryejë rrjedhimisht edhe trajtimin e të dhënave për llogari të Titullarëve të tjerë të trajtimit, dhe për këtë gjë është e ligjëruar, në përputhje me nenin 28 të RGPD-së, me një akt ligjor që e përcakton atë si Përgjegjëse për trajtimin e të dhënave.
Subjektet që, për arsye të ndryshme, ndërhyjnë në proceset e kurave dhe në proceset administruese dhe teknike-administrative për mbështetjen e dhënies së shërbimeve, janë të autorizuar për të bërë trajtimin në përputhje me nenin 29 të RGPD-së për fushën specifike të kompetencave të tyre dhe kur janë të formuar në mënyrë adekuate për ta bërë këtë gjë.

Të dhënat e kontaktit.
Titullari për trajtimin e të dhënave: …....……. ……...
Përfaqësuesi ligjor: … …….
Përgjegjësi për mbrojtjen e të dhënave personale: …….. …
Autoriteti i kontrollit: Garanti për mbrojtjen e të dhënave personale, **www.garanteprivacy.it**, e-mail **garante@gpdp.it**, centrali tel. 06696771